



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më 05 .3.2018

NJOFTIM PËR VEND PUNE

1. Lëvizja paralele brenda të njëjtës kategori

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu V – "Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë", nenit 26, "Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2014 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", Kreu II, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njofton se;

a) Në Administratën e KQZ-së ka 1(një) vend të lirë pune në kategorinë e ulët drejtuese, në pozicionin Përgjegjës Sektori për Edukimin e Zgjedhësve. Kategoria e pagës III-a/1.

b) Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion:

1. Jep hollësi për strategjinë e edukimit zgjedhor të shtetasve, projekteve programeve të cilat do të miratohet nga KQZ;
2. Kontribuon në gjetjen dhe përcaktimin e drejtimeve, formave, metodologjive e mjeteve sa më bashkëkohore dhe produktive, në përmbushje të detyrimit ligjor për edukimin zgjedhor të shtetasve;
3. Jep hollësi për target grupet e veçanta të zgjedhësve, dhe për programet specifike për edukim zgjedhor të tyre;
4. Përgatit materiale për projekt-akte për edukimin zgjedhor të shtetasve duke përcaktuar drejtime forma dhe mjete bashkëkohore për realizimin më efektivitet dhe efçencë të edukimit zgjedhor të shtetasve;
5. Evidenton/ideon formën dhe përmbajtjen e materialeve që do të përdoren për edukim, sipas kriterëve ligjore dhe atyre të miratuara nga KQZ-ja;
6. Ndjek procesin e përgatitjes/prodhimit të materialeve që do të përdoren për edukimin zgjedhor të shtetasve, në periudhe zgjedhore dhe jashtë saj, merr masat e nevojshme për kryerjen në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të tyre;
7. Kryen në vijimësi sesione edukuese me kategori të ndryshme zgjedhësish, mbi bazën e materialeve leksioneve të përgatitura për këtë qëllim në përputhje me specifikat e target grupeve të cilat do të jenë objekt i edukimit zgjedhor;
8. Krijon evidenca të sakta për numrin e pjesëmarrësve në sesionet e edukimit, harton dhe paraqet raporte vlerësimi për ecurinë e tyre, dhe bazuar në to, evidenton mënyra, gjetje, forma të reja për dërgimin më pranë zgjedhësit të informacionit edukues/sensibilizues/informues;
9. Informon në kohë dhe paraqet raporte më shkrim tek eprori e drejtpërdrejtë për ecurinë e çdo veprimtarie edukuese të realizuar në periudhë zgjedhore dhe jo zgjedhore;

- **Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:**
 - të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
 - të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - të ketë, të paktën, vlerësimin e fundit "Mirë" apo "Shumë mirë";
 - të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- **Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:**
 1. Arsimit i lartë, master shkencor, shkencat e komunikimit (dega gazetari).
 2. Të ketë përvojë pune jo më pak se tre vjet, në pozicione të nivelit të ulët drejtues.
 3. Të ketë njohuri të gjera të demonstruara në fushën e edukimit, legjislaionit, njohuri shumë të mira të procedurave zgjedhore, administrative, aftësi për të përcaktuar objektiva dhe vendosur prioritete dhe respektuar afatet, aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe koordinuar punën e stafit nën varësi, aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi, aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja, aftësi për të punuar në grup, transparencë në punë, aftësi për të punuar në kushte specifike, me orar të zgjatur edhe jashtë vendbanimit.
 4. Të disponojë dëshmi/certifikatë dhe të flasë e të shkruajë një gjuhë të BE, avantazh anglisht.
- Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në zyrën e protokollit në KQZ këto dokumenta:
 - letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
 - një kopje të jetëshkrimit(C.V);
 - fotokopje e diplomës- në se aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëhere ai duhet ta ketë të njehësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin; fotokopje e listës së notave- në se ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëhere aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
 - një fotokopje e librezës së punës e plotësuar;
 - vërtetim i gjendjes gjyqësore; certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
 - fotokopje e letërnjoftimit,
 - aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues
 - Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - formularët e vlerësimit të punës për periudhën janar – qershor për vitin 2017,
 - Formularin e vetëdeklarimit të të dhënave të plotësuar sipas rubrikave në zbatim të ligjit 138/2015" Për integritetin e personave që zgjidhen, emërohen....." etj
- Afati i dorëzimit të dokumentave është data **14.03.2018**, 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga moment i shpalljes në portal.
- Në datën **16.03.2018**, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin (në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të KQZ-së dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër. Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen me telefon ose mail. Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.
- Konkurrimi- intervista me gojë do të bëhet në datën **28.03.2018**, në mjediset e KQZ, në orën 12-00

- Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, Kodi Zgjedhor i ndryshuar, Ligjin "Për nëpunësin civil", Kodin e Procedurave Administrative, ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të administratës së KQZ-së.
- Kandidatët do të vlerësohen nga "Komiteti i Pranimit për Lëvizjen Paralele"(KPLP), i ngritur pranë institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. *Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 40 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë: 20 pikë përvojën, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për çertifikimin pozitiv apo për vlerësimin e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer dhe 60 pikë për intervistën me gojë.*
- Njësia përgjegjëse (Burimet Njerëzore) do të njoftojnë kandidatët për rezultatin e konkurrimit, në mënyrë individuale në datën 30.03.2018.
- Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele" (KPLP), brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.
- Lista e fituesve me 70 pikë e lartë (70% të pikëve e lartë) do të shpallet në datën 09.04.2018 në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen zyrtare të KQZ- së dhe në standën e informimit të publikut.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të kategorisë së ulët drejtuese, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Në se nga procedura e mësipërme nuk paraqitet apo shpallet anjë fitues, konkurrimi do të vazhdojë me procedurën si më poshtë:

2. Ngritja në Detyrë.

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu V – "Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë", nenit 26, "Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2014 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", Kreu III, "Ngritja në detyrë", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, njofton se;

Në Administratën e KQZ-së ka 1(një) vend të lirë pune në kategorinë e ulët drejtuese, në pozicionin Përgjegjës Sektori për Edukimin e Zgjedhësve. Kategoria e pagës III-a/1.

Në zbatim të vendimit nr.272 prot., datë 01.03.2018, të Titullarit të të KQZ-së, procedura do të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil që plotësojnë kërkesat e veçanta për këtë vend pune.

- *Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për ngritjen në detyrë janë:*
 1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar të një kategorie më të ulët, në të njëjtin institucion apo institucione të tjera të shërbimit civil.
 2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
 3. Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv, mirë ose shumë mirë.
 4. Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil.
 5. Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

- Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Jep hollësi për strategjinë e edukimit zgjedhor të shtetasve, projekteve programeve të cilat do të miratohet nga KQZ;
2. Kontribuon në gjetjen dhe përcaktimin e drejtimeve, formave, metodologjive e mjeteve sa më bashkëkohore dhe produktive, në përmbushje të detyrimit ligjor për edukimin zgjedhor të shtetasve;
3. Jep hollësi për target grupet e veçanta të zgjedhësve, dhe për programet specifike për edukim zgjedhor të tyre;
4. Përgatit materiale për projekt-akte për edukimin zgjedhor të shtetasve duke përcaktuar drejtime forma dhe mjete bashkëkohore për realizimin më efektivitet dhe efikasitet të edukimit zgjedhor të shtetasve;
5. Evidenton/ideon formën dhe përmbajtjen e materialeve që do të përdoren për edukim, sipas kriterëve ligjore dhe atyre të miratuara nga KQZ-ja;
6. Ndjek procesin e përgatitjes/prodhimit të materialeve që do të përdoren për edukimin zgjedhor të shtetasve, në periudhe zgjedhore dhe jashtë saj, merr masat e nevojshme për kryerjen në kohë dhe me cilësinë e kërkuar të tyre;
7. Kryen në vijimësi sesione edukuese me kategori të ndryshme zgjedhësish, mbi bazën e materialeve leksioneve të përgatitura për këtë qëllim në përputhje me specifikat e target grupeve të cilat do të jenë objekt i edukimit zgjedhor;
8. Krijon evidenca të sakta për numrin e pjesëmarrësve në sesionet e edukimit, harton dhe paraqet raporte vlerësimi për ecurinë e tyre, dhe bazuar në to, evidenton mënyra, gjetje, forma të reja për dërgimin më pranë zgjedhësit të informacionit edukues/sensibilizues/informues;
9. Informon në kohë dhe paraqet raporte më shkrim tek eprori e drejtpërdrejtë për ecurinë e çdo veprimtarie edukuese të realizuar në periudhë zgjedhore dhe jo zgjedhore;

- **Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:**

- Arsim i lartë, master shkencor, shkencat e komunikimit (dega gazetari).
- Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet, në pozicione të nivelit ekzekutiv,administratë shtetërore, media.
- Të ketë njohuri të gjera të demonstruara në fushën e edukimit, legjislaclacionit, njohuri shumë të mira të procedurave zgjedhore, administrative, aftësi për të përcaktuar objektiva dhe vendosur prioritete dhe respektuar afatet, aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe koordinuar punën e stafit nën varësi, aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi, aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja, aftësi për të punuar në grup, transparencë në punë, aftësi për të punuar në kushte specifike, me orar të zgjatur edhe jashtë vendbanimit.
- Të disponojë dëshmi/certifikatë dhe të flasë e të shkruajë një gjuhë të BE, avantazh anglisht

Kandidatë të tjerë,nga jasht shërbimit civil duhet të plotësojnë, kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21,të ligjit 152/2013“Për nëpunësin civil”i ndryshuar,

a-Të jetë shtetas shqipëtarë;

b-Të ketë zotësi për të vepruar;

c-Të zotërojë gjuhën shqipe,të shkruar dhe të folur;

d-Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

e-Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtje penale me dashje.

f-Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga shërbimi civil,që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013“Për nëpunësin civil” i ndryshuar,apo në institucion public ,privat ku ka qenë punësuar.

- **Kritere të veçanta;**

- Arsim i lartë, master shkencor, shkencat e komunikimit (dega gazetari).
- Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vite në median qendrore.
- Të ketë njohuri të zgjeruara të demonstruara në fushën e edukimit, legjislacionit, njohuri shumë të mira të procedurave zgjedhore, administrative, aftësi për të përcaktuar objektiva dhe vendosur prioritete dhe respektuar afatet, aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe koordinuar punën e stafit në varësi, aftësi shumë të mira komunikimi, aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja, aftësi për të punuar në grup, transparencë në punë, aftësi për të punuar në kushte specifike, me orar të zgjatur dhe jashtë vendbanimit.

Të disponojë dëshmi/certifikatë dhe të flasë e të shkruajë një gjuhë të BE, avantazh ka gjuha angleze.

- Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të KQZ-së, dokumenta si më poshtë:
 - letër motivimi për aplikim në vendin vakant,;
 - një kopje të jetëshkrimit(C.V);
 - fotokopje e diplomës- në se aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëhere ai duhet ta ketë të njehësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin; fotokopje e listës së notave- në se ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëhere aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
 - një fotokopje e librezës së punës e plotësuar;
 - vërtetim i gjendjes gjyqësore; certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
 - fotokopje e letërnjoftimit, fotokopje të kartës së identitetit.
 - aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues
 - formularët e vlerësimit të punës për periudhën janar – dhjetor për vitin 2017.
 - Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
 - Formularin e vetëdeklarimit të të dhënave të plotësuar sipas rubrikave në zbatim të ligjit 138/2015“Për integritetin e personave që zgjidhen,emërohen.....”etj
- Afati i dorëzimit të dokumentave është data 19.03.2018.
- Në datën 27.03.2018 do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KQZ- së dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të ngritjes në detyrë dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër.Kandidatët e skualifikuar do të njoftohen me telefon ose – maile. -Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.
- Konkurimi- testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, do të bëhet në datën 11.04.2018 në mjediset e KQZ- së, në orën 10-00.
- Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë, i ngritur pranë institucionit të KQZ. *Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100*, të cilat ndahen përkatësisht: 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar (eksperiencë, trajnime, kualifikime të lidhura me fushën përkatëse, si dhe 2 vlerësimet e fundit pozitive); 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë dhe 40 pikë për vlerësimin me shkrim.

- Lista e fituesve me 70 pikë e lartë (70% të pikëve dhe lartë) do të njoftohet në datën 13.04.2018. Kandidatët do të njoftohen me telefon ose – emaile.
- Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

Shpallja e fituesit do të bëhet në datën 20.04.2018, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, si dhe në faqen zyrtare të KQZ-së.

- **Kandidatët nga jashtë shërbimit civil do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë institucionit të KQZ-së. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht:**
 - vlerësimi i jetëshkrimit - 15 pikë,
 - intervista e strukturuar me gojë - 25 pikë,
 - testimi me shkrim - 60 pikë.
- **Nëse kandidati grumbullon më shumë se gjysmën e pikëve (mbi 30 pikë) nga vlerësimi me shkrim, ai kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë dhe vlerësimin e jetëshkrimit.**
- **Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore